



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.97/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses C... sh.p.k., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati N.H. nga Prishtina, kundër të paditurës B... (B...) me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim S.B. nga Prishtina, për kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.339/15 e datës 19/03/2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **28/02/2020**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e paditëses C... sh.p.k., me seli në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.339/15 e datës 19/03/2018.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin ankimor III.EK.nr.339/15 e datës 19/03/2018, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të refuzon si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses C... sh.p.k., me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura B... (B...) me seli në Prishtinë, t'ia paguaj paditëses në emër të kompensimit të dëmit shumë prej 14,969.49 euro, me kamatë vjetore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore, në afatin kohor prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit ka vendosur që shpenzimet e procedurës kontestimore ti bartin secila palë veç e veç.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësja ka paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar të ndryshohet dhe të gjykohet në favor të paditëses C... sh.p.k., me seli në Prishtinë,

E paditura ka dhënë përgjigje në ankesë, me propozim që të refuzohet ankesa e paditëses si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 200 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditëses është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja C... sh.p.k, me seli në Prishtinë, pran Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 03/08/2015, ka paraqitur padi kundër të paditurës B... (B...) me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi, me kërkesë të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke arsyetuar se paditësja vetë e ka plotësuar urdhër pagesën dhe e ka nënshkruar të njëjtën, duke urdhëruar të paditurën B... (B...) me seli në Prishtinë, që të bëjë transferimin e shumës sipas të dhënave në urdhër pagesë edhe përkundër asaj se zyrtarja e të paditurës e ka njoftuar paditësen se “I. po del se është në Angli e jo në Slloveni”, lidhur me këtë njoftim paditësja nuk ka marr ndonjë veprim për të siguruar tek furnitori i tij, lidhur me verifikimin e gjiro-llogarisë të përshkruar si në urdhër pagesë edhe përkundër këtyre rrethanave, paditësja urdhëron ekzekutimin e kësaj pagese, andaj gjykata e shkallës së parë, me provat e administruar nuk ka gjetur ndonjë lëshim eventual të paditurës se e njëjta gabimisht e ka transferuar shumën prej 14,969.49 euro dhe mbi këto arsye ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 136 dhe nenin 138 të LMD-së si dhe nenin 143 të LPK-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata Apelit e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses duke gjetur se e njëjta është e bazuar. Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet e ankuesit për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë sepse në bazë të provave të administruara gjykata ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe atë duke u bazuar në urdhërpagesën ndërkombëtare ref.60000000051055 e datës 15/06/2015, nga e cila provë është vërtetuar bindshëm se paditësja ka urdhëruar transferimin e të hollave në shumë prej 14,969.49 euro, tek përfituesi M... D.O.O, në adresë ..., Slloveni, nga e cila urdhër pagese shihet qartë se I... dhe S..., ka qenë në Britani të Madhe. Nuk ishte kontestuese në mes palëve ndërgjyqësve se zyrtarja e të paditurës, me rastin e përgatitjes së urdhër pagesës e ka njoftuar paditësen se gjiro-llogaria e përfituesit gjendet në Angli e jo në Slloveni, edhe për kundër këtij njoftimi, paditësja ka urdhëruar ekzekutimin e urdhërpagesës ndërkombëtare duke e nënshkruar të njëjtën dhe duke u pajtuar se për çdo informatë të mangët nga ana e klientit, banka nuk mban përgjegjësi në rast kthimit të mjeteve. Paditësja C... sh.p.k, me seli në Prishtinë, përmes e-mailit të datës 23/06/2015, ka kërkuar nga e paditura që urgjentisht të bëjë kërkesë për kthimin e mjeteve, me arsye se përfituesi nuk ka llogari jashtë vendit, përveç në Slloveni dhe shpreh dyshime se ka qenë i mashtruar nga hakerët. E paditura B... (B...) me seli në Prishtinë, pas pranimit të njoftimit nga paditësja, menjëherë ka vepruar për evitimin e pasojave-ndalimin e transferimit eventualisht kthimin e të hollave të transferuara, por nga banka përfituese është njoftuar se të hollat e transferuara janë tërhequr dhe nuk mund të kthehen mjetet prapa.

Gjykata e shkallës së parë, në rastin konkret me të drejtë ka vërtetuar se e paditura nuk ka asnjë lëshim në shkaktimin e dëmit të pretenduar, përkundrazi deri te demi, ka ardhur nga pakujdesia e rënd e paditëses, për shkak se zyrtarja e të paditurës me kohë e ka njoftuar paditësen se I... dhe S..., është në Britani të Madhe e jo në Slloveni, mirëpo paditësja edhe përkundër këtij fakti relevant, nuk ka ndërmarr veprime për të verifikuar gjiro-llogarin e përfituesit dhe nga urdhërpagesa ndërkombëtare vërtetohet se paditësja është pajtuar se e paditura nuk merr përgjegjësi në rast se të dhënat janë të mangëta, andaj nga kjo neglizhencë e paditëses, nuk mund ti atribuohet faji të paditurës për shkaktimin e dëmit respektivisht me këtë gjendje faktike të vërtetuar nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të aplikuar norma juridike të paraparë me nenin 136 të LMD-së.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke dhënë arsye të mjaftueshme, ndërsa pretendimet e paditëses janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195 par.1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
Ae.nr.97/18, me datën 28/02/2020

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku, d.v